



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2025

Lënda: Gjuhë shqipe

Udhëzime për nxënësin:

Testi përmban gjithsej **50 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **25 pyetje**.

Për pyetjet me alternativa rrethoni vetëm përgjigjen e saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6
Pikët						
Pyetja	7	8	9	10	11	12
Pikët						
Pyetja	13	14	15	16	17	18
Pikët						
Pyetja	19	20	21	22	23	24
Pikët						
Pyetja	25a	25b	25c	25d		
Pikët						

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I

Lexoni historinë e mëposhtme, pastaj përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Misteri i shpellës

Kur u gjenda në rrugën e madhe, vura re se s'kishte njeri. Nën ullinj loznin hijet e thella, kurse në pllajat e zhveshura kish nisur të shquhej drita e agimit. S'kisha parë kurrë një agim të tillë. Në qiell yjet po humbisnin e shkriheshin si kokrrat e sheqerit në ujë të ftohtë. Nën mua deti i qetë flinte i madhërishtëm. Ç'qetësi dhe bukuri e rrallë! Atje lart Malet e Vetëtimës, si kështjellë shekullore, ngriheshin hijerëndë, kurse plazhi përposh si një top basme e bardhë e hapur tej e tej, që nga kampi i Pushimit të Punëtorëve e deri te kepi i Shpellës së Piratëve, nanurisej lehtë nga pëshpëritjet e fjetura të valëve të lodhura.

Unë shkova drejt shpellës duke ndier një frikë të vogël, por duke u munduar të mos e tregoj. Në hyrje të shpellës, një kështjellë e vjetër e rrënuar, me mure të shkatërruara dhe me një portë të madhe prej guri, dukej si një hyrje për në botën e errësirës. Fëmijët e tjerë më prisnin atje, dukej se ishin të gatshëm për një eksplorim të madh. Loloja, njëri prej tyre, dukej i vendosur dhe i guximshëm, duke ecur në krye të grupit.

-Fol, o stërgjyshi ynë! Kundër kujt luftove? A më dëgjon? Të flas unë. Ti dhe shpirt këtu brenda në errësirë, se vendi yt atëherë ishte në luftë me piratët. Tani s'ka më piratë vendi ynë. Tani jemi bërë zotër të vendit tonë. Po, o luftëtar i kohëve të lashta, edhe gjyshërit tanë, edhe prindërit tanë e ndoqën me besnikëri gjer në vdekje rrugën tuaj të heroizmave për liri kundër çdo pirati.

Kur u futëm në shpellë, gjithçka dukej misterioze dhe e frikshme. Heshtja ishte aq e thellë sa që mund të dëgjohej edhe frymëmarrja e fëmijëve. Në errësirën e dendur, shfaqeshin hije dhe figura të panjohura, duke na bërë të ndiejmë frikë dhe emocion të madh. Por Loloja vazhdoi të udhëheqë grupin, duke na çuar nëpër korridore të ngushta dhe nëpër dhoma të fshehta.

Qoftë i mallkuar ai që do të jetojë duke lënë vendin të shkelet nga këmba e huaj! Kur t'i hedhësh sytë nga malet tona, kujto se ato janë streha dhe kalaja jonë shekullore! Ato janë miku ynë besnik. Dhe kur të hedhësh sytë nga deti, kujto se në valët e tij janë shtrirë kokallat e gjyshit tënd dhe të babait tënd! Mbrojeni detin tonë dhe gjithnjë fytyrën e mbani drejt tij me krenari, se është deti ynë, është jeta jonë!

Ne vazhduam të eksplorojmë shpellën, duke zbuluar gjëra të reja dhe duke ndier një emocion të madh. Në një nga dhomat e fshehta, gjetëm një tabelë të vjetër, e cila dukej si një hartë e fshehtë. Loloja e mori dhe e shpjegoi me një zë të ulët, duke na treguar se kjo ishte një hartë e vjetër e piratëve, që tregonte vendin ku ishin fshehur thesaret e tyre. Fëmijët të gjithë u emocionuan dhe filluan të flasin për aventurat e tyre të ardhshme.

Kur dolëm nga shpella, dielli ishte lart në qiell dhe deti dukej edhe më i qetë. Ne u ulëm në plazh, duke shijuar një pushim të merituar pas eksplorimit të gjatë. Loloja filloi të na tregojë histori të vjetra për piratët dhe për luftërat e tyre kundër shqiptarëve. Historitë e tij na bënë të ndiejmë një krenari të madhe për të parët tanë dhe për vendin tonë. Ne u betuam të mbrojmë gjithmonë vendin tonë dhe të ruajmë historinë e tij me krenari.

Marrë nga romani "Shpella e piratëve", Petro Marko

1. Fëmijët hyjnë në shpellë që:

1 pikë

- A) të gjejnë një hartë të fshehtë piratësh.
- B) të qëndrojnë larg shkollës për një ditë.
- C) të tregojnë guximin e tyre përpara prindërve.
- D) të mbledhin gurë të rrallë për koleksionin e tyre.

2. Atmosfera e shpellës duket e frikshme nga:

1 pikë

- A) prania e një pirati të vërtetë.
- B) zhurmat e fëmijëve që bërtasin.
- C) heshtja e thellë dhe hijet misterioze.
- D) rënkimi i detit dhe krismat e gurëve.

3. Fëmijët ndihen krenarë për të parët e tyre, sepse ata: **1 pikë**
- A) ishin piratë të njohur.
B) kishin shumë pasuri dhe thesare.
C) kishin zhvilluar ekonominë detare.
D) luftuan për lirinë e vendit dhe trashëgiminë.
4. Mbështetur në kontekstin e dhënë, fjalia: "*Janë shtrirë kokallat e gjyshit tënd dhe të babait tënd,*" nënkupton se: **1 pikë**
- A) ata janë të varrosur në det.
B) deti është pjesë e trashëgimisë kulturore të familjes.
C) deti tregon lidhjen e ngushtë mes familjes dhe natyrës.
D) deti është simbol i sakrificës dhe lidhjes mes brezave të ndryshëm.
- 5.
- a) Çfarë emocionesh zgjon natyra te personazhi kryesor në paragrafin e parë? **2 pikë**
- _____
- _____
- _____
- b) Cilat janë dy fjalët që e përshkruajnë më së miri karakterin e Lolos bazuar në këtë fragment? **2 pikë**
- _____
- _____
- 6.
- a) Në cilën vetë rrëfohen përjetimet dhe ngjarjet në këtë fragment? **1 pikë**
- _____
- b) Si ndikon ky rrëfim i personazhit te lexuesi? **1 pikë**
- _____
7. Identifikoni dy figura letrare në fjalinë: "*Yjet në qiell po veniteshin dhe shkriheshin ngadalë, si kokrrat e sheqerit në një gotë me ujë të kaltër.*" **2 pikë**
- _____
- _____

PJESA II

Udhëtim për në fshatin FSHAT

Një fshat që quhet thjesht Fshat nuk është një gjë që të ndodh shpesh. Ndërsa shkonim për te shtëpia e profesorit, na kishte bërë përshtypje ky fshat i ndarë në pesë lagje të vendosura në disa shpate kodre që shkojnë që nga 200 metra deri në 800 mbi nivelin e detit. Shumë shtëpi janë të reja, por ka ende shumë të tjera që ruajnë gjurmët e kohës. Të rrethuara nga gjelbërimi, kullat e vjetra na dukeshin sikur kërkonin të ruheshin nga sytë e kureshtarëve, qofshin këta edhe të pakët si puna jonë.

Ndërsa ecnim përmes këtij fshati të veçantë, edhe në dukje e vrisnim mendjen mbi emrin e tij. Një fshat që nuk ka nevojë për emër. Kjo ishte gjetja e parë që na shkoi ndër mend. Porse profesori mendon ndryshe, dhe ai sigurisht që e di këtë punë më mirë se ne. Sipas një hyrjeje që ai ka shkruar në libër: "Fshati deri në ditët tona ka qenë i njohur me emrin Fushat. Gojëdhënat e tregojnë këtë emër të lidhur me shprehjen: Zbresim nga kalaja në fushat, e përdorur që nga koha e Kastriotëve. Kështu, emri i qytetit të Petralbës mbeti 'Fushat' dhe më vonë, me rënien e u-së, u shndërrua në Fshat."

Në këmbët e vendit ku po shkelim, ka qenë dikur Petralba mesjetare që Barleti e përmend si vendin ku Skënderbeu gjatë verës linte të shoqen. Rrëzë kështjellës, – shkruan historiani i Skënderbeut, - ishte një fushë me një bukuri të veçantë, si nga hijeshia e vetë natyrës dhe e vendit, si nga punimi plot kujdes i banorëve, saqë s'i mungonin as frutat, asgjë nga ato që begatojnë dhe zbukurojnë tokën. Atje zonja, bashkë me familjen dhe me vargje të pambaruara vajzash e me shërbime mbretërore sipas zakonisht e kalonte atë pjesë të vitit.

Rreth e rrotull, nga çdo anë e fushës ishin pyje të paafrueshme dhe ngushtica luftëtarësh për ruajtjen e saj. Dhe vetë qytetin e kishte pajisur si jo më mirë me burra, armë dhe ushqime për çdo rast. Rrënojat e kështjellës së njohur tashmë janë identifikuar mbi malin që ngrihet përmbi fshatin Fshat. Jo shumë larg rrënojave ngrihet fshati i njohur Guri i Bardhë, vendlindja e Pjetër Budit. Guri i Bardhë në latinisht do të thotë Petralba, porse profesori mendon se rrënojat e qytetit të vjetër shtrihen diku nën këmbët tona në territorin Fshat.

Profesori e ka tashmë gati teorinë: Kemi të bëjmë me një vendbanim që ka nisur jetë në shekullin VI para Krishtit dhe ka pasur një rindërtim nja një mijë vjet më vonë. Histori e gjatë, por edhe fort e ngatërruar. Sa mirë sikur ndonjë arkeolog prej vërteti të hidhte ndonjë sy nga këto anë!

Shkruar nga Fatos Baxhaku

8. Sipas gojëdhënave, emri "Fshat" u formua nga: 1 pikë
- A) një emër që u shpik rishtazi nga banorët.
 B) mungesa e ndonjë ndërtese historike në atë zonë.
 C) fakti që vendbanimi nuk kishte nevojë për një emër specifik.
 D) shprehja "Zbresim nga kalaja në fushat", e lidhur me Kastriotët.
9. Cila veçori e vendndodhjes së fshatit përmendet në paragrafin e parë? 1 pikë
- A) Ndodhet në një ishull të largët mes detit.
 B) Është i ndarë në pesë lagje në shpate kodrash.
 C) Gjendet në një qytet të madh pranë një kalaje.
 D) Ndodhet në një fushë të sheshtë pranë një lumi.
10. Në cilën nga alternativat e mëposhtme gjuha e përdorur nga autori shpreh emocion? 1 pikë
- A) Profesori e ka tashmë gati teorinë.
 B) Fshati deri në ditët tona ka qenë i njohur me emrin Fushat.
 C) Rrënojat e kështjellës së njohur janë identifikuar mbi malin që ngrihet përmbi fshatin Fshat.
 D) Të rrethuara nga gjelbërimi, kullat e vjetra na dukeshin sikur kërkonin të ruheshin nga sytë e kureshtarëve.

11. Shprehja “ruajnë gjurmët e kohës” në tekst nënkupton se:

1 pikë

- A) ndërtimet kanë mbetur të paprekura nga koha.
- B) shtëpitë janë të shkatërruara dhe të pabanueshme.
- C) shtëpitë janë të reja, por të ndërtuara me stilin e vjetër.
- D) banesat janë të braktisura dhe nuk shihen më nga askush.

12. Identifikoni në tekst dy fakte të rëndësishme për fshatin.

2 pikë

Fakt gjeografik _____

Fakt historik _____

13. Në paragrafin e tretë dhe të katërt, autori ofron dy pamje për fushën dhe rëndësinë e saj historike. Cilat janë ato?

2 pikë

Fusha në paragrafin e tretë përshkruhet si: _____

Fusha në paragrafin e katërt përshkruhet si: _____

14. Cili është kuptimi i emrit të fshatit sipas gojëdhënave dhe sipas historianëve?

2 pikë

Sipas gojëdhënave: _____

Sipas historianëve: _____

15. Bazuar në tekst, si e përfytyron autori të kaluarën e kësaj fushe dhe banorëve të saj? A mund të bëhet ky vend një pikë tërheqëse e turizmit kulturor? Jepni dy argumente të marra nga teksti.

3 pikë

16. Rrënja e fjalës *ngushticë* është:

1 pikë

- A) ngushto.
- B) ngushtë.
- C) i ngushtë.
- D) ngushtuar.

17. Emërtoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë:

2 pikë

Rrënojat e kështjellës së njohur tashmë janë identifikuar mbi malin që ngrihet përmbi fshatin Fshat.

rrënojat _____

tashmë _____

18. Në fjalinë: “Nga hijeshia e vetë natyrës dhe e vendit”, emri i nënvizuar është:

1 pikë

- A) në gjinore të shquar.
- B) në kallëzore të shquar.
- C) në dhanore të pashquar.
- D) në dhanore të shquar.

19. Në cilën nga alternativat, **kryefjala e fjalisë**: “Fshati deri në ditët tona ka qenë i njohur me emrin Fushat,” zgjerohet me një emër me parafjalë të rasës kallëzore?

1 pikë

- A) Fshati i njohur.
- B) Fshati afër malit.
- C) Fshati mbi kodrinë.
- D) Fshati nga ana jugore.

20. Identifikoni trajtën e shkurtër në fjalinë më poshtë dhe përcaktoni vetën dhe rasën e saj.

3 pikë

Ndërsa shkonim për te shtëpia e profesorit, na kishte bërë përshtypje ky fshat.

Trajta e shkurtër: _____

Veta: _____

Rasa: _____

21.

a) Grupin emëror **vargje të pambaruara** vendoseni në numrin njëjës, në rasën dhanore.

2 pikë

b) Gjeni trajtën e saktë të foljes në mënyrën habitore në fjalinë:

1 pikë

Rrënojat e qytetit të vjetër shtrihen diku nën këmbët tona në territorin e fshatit.

- A) shtrikan
- B) u shtrikan
- C) shtrikështa
- D) u shtrikështa

c) Paskajoren e foljes **shkoj** përdoreni në fjali një herë me funksion qëllimor dhe një herë si përcaktor.

2 pikë

Funksion qëllimor: _____

Si përcaktor: _____

22. Cili është funksioni i fjalës së nënvizuar në fjalinë e dhënë më poshtë?

2 pikë

Në këmbët e vendit ku po shkelim, ka qenë dikur Petralba mesjetare që Barleti e përmend si vendin ku Skënderbeu gjatë verës linte të shoqen.

Funksioni: _____

Shprehur me: _____

23. Përcaktoni llojin e kallëzuesit të nënvizuar. Tregoni me se shprehet.

2 pikë

Shumë shtëpi janë të reja, por ka ende shumë të tjera që ruajnë gjurmët e kohës.

Lloji: _____

Shprehur me: _____

24.

a) Përcaktoni llojin e fjalisë sipas gjymtyrës kryesore.

1 pikë

Histori e gjatë, por edhe fort e ngatërruar.

b) Qarkoni fjalinë e përbërë me nënrenditje përcaktore.

1 pikë

A) Kjo ishte gjetja e parë që na shkoi ndër mend.

B) Kërkonin të ruheshin nga sytë e kureshtarëve.

C) Jo shumë larg rrënojave ngrihet fshati i njohur Guri i Bardhë.

D) Ndërsa ecnim përmes këtij fshati të veçantë, edhe në dukje e vrisnim mendjen mbi emrin e tij.

